



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2515, datë 06.11.2014

Për

“Revokimin e Licencës së Përgjithshme Kombëtare Nr. 02, datë 04.05.2011, e ndryshuar, për Ofrimin e Shërbimeve Postare, të Ofruesit të Shërbimeve Postare “Postalink” sh.p.k.”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

| | | |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtar |
| 4. Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare Znj.M.Drushku, në mbledhjen e datës 06.11.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji Nr. 8530, datë 23.09.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar dhe ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, mori në shqyrtim, çështjen me objekt:

- *Revokimin e Licencës së Përgjithshme Kombëtare për Ofrimin e Shërbimeve Postare Nr. 02, datë 04.05.2011, ndryshuar datë 12.07.2011, të Ofruesit të Shërbimeve Postare “Postalink” sh.p.k.*

BAZA LIGJORE:

- Ligji Nr. 8530, datë 23.09.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, neni 121 e në vijim;
- Rregullore Nr. 21, datë 18.03.2011 për “Licencën e Përgjithshme për Ofrimin e Shërbimeve Postare”, e ndryshuar, gërma d), pika 2, neni 8 dhe neni 9;

- Rregullore Nr. 28, datë 28.12.2012 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare”, Kreu II;

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Projekt-vendimi;
- Relacioni shpjegues mbi Projekt-Vendimin (*Relacioni*)
- Dokumentacioni mbështetës:
 - o Kopje e shkresës me Nr. 993 prot, datë 11.04.2014 (AKEP) me lëndë “*Njoftim mbi dërgimin online të të dhënave statistikore dhe financiare postare të Vitit 2013*”, dërguar Ofruesit të Shërbimeve Postare “Postalink” sh.p.k;
 - o Kopje e zarfit të shkresës së kthyer me Nr. 993 prot, datë 11.04.2014 nga Posta Shqiptare si adresë e panjohur;
 - o Kopje e shkresës Nr. 512 prot , datë 19.03.2013 me lëndë “*Dërgim fature për shlyerjen e detyrimeve*”;
 - o Kopje e shkresës Nr. 1701 prot , datë 14.10.2013 me lëndë “*Njoftim për shlyerjen e detyrimeve*”;
 - o Kopje e zarfit të shkresës së kthyer me Nr. 1701 prot, datë 14.10.2013 nga Posta Shqiptare si adresë e pamjaftueshme;
 - o Kopje e shkresës me Nr. 1684/1 prot, datë 04.07.2014, me lëndë “*Dërgim Njoftimi*” Ofruesit të Shërbimeve Postare “Postalink” sh.p.k;
 - o Kopje e zarfit të shkresës së kthyer me Nr. 1684/1 prot, datë 04.07.2014 nga Posta Shqiptare si adresë e panjohur.
- si dhe,
duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar.

V Ë R E N:

- Ofruesi i Shërbimeve Postare “Postalink sh.p.k.” është i pajisur me Licencë të Përgjithshme Kombëtare për Ofrimin e Shërbimeve Postare Nr. 02, datë 04.05.2011, ndryshuar datë 12.07.2011, me afat vlefshmërie 10 vjet.
- Gjatë punës analizuese të përmbushjes së detyrimeve ligjore nga ana e ofruesve të shërbimeve postare strukturat përgjegjëse të AKEP kanë konstatuar se ofruesi i Shërbimeve Postare “Postalink sh.p.k.” nuk ka kryer pagesat për licencë për vitin 2013 dhe vitin 2014, si dhe nuk ka dërguar të dhënat statistikore dhe financiare postare për vitin 2013, për periudhën 01.01.2013 - 31.12.2013.
- AKEP, bazuar në faktet e përmendura më sipër, si dhe në zbatim të procedurave, ka kërkuar nga Ofruesi i Shërbimeve Postare “Postalink” sh.p.k. përmbushjen e detyrimeve ligjore si me poshtë:

- Me email datë 04.03.2014 dhe email datë 08.04.2014 i ka dërguar “Postalink” sh.p.k. “Njoftim mbi dërgimin online të të dhënave statistikore dhe financiare postare të Vitit 2013”.
- Me shkresën Nr. 993 prot, datë 11.04.2014, me lëndë “Njoftim mbi dërgimin online të të dhënave statistikore dhe financiare postare të Vitit 2013” ka njoftuar “Postalink” sh.p.k. mbi detyrimin e aplikimit dhe dërgimit në Modulin e Aplikimeve Online “Formularin 14” – Të dhëna për Shërbimet postare të ofruara për periudhën 01.01.2013-31.12.2013.
“Postalink” sh.p.k nuk i është përgjigjur email-ve të dërguara dhe shkresës së sipërcituar.
- Me shkresën nr. 512, (Prot AKEP) datë 19.03.2013, ka dërguar bashkëngjitur faturën për shlyerjen e detyrimeve për vitin 2013, si dhe për adresë të pamjaftueshme nuk është dorëzuar nga shërbimi postar shkresa nr.1701, (prot AKEP) datë 14.10.2013 “Njoftim për shlyerjen e detyrimeve” për vitin 2013.
- AKEP, bazuar në faktin juridik të përmëndur më sipër, filloi procedurën për revokimin e Licencës së Përgjithshme të shërbimeve postare, në zbatim të së cilës me shkresën Nr. 1684/1 Prot., datë 04.07.2014, me lëndë “Dërgim Njoftimi”, bëri me dije Ofruesin e Shërbimeve Postare “Postalink sh.p.k”, për fillimin e procedurave për revokimin e Licencën e Përgjithshme Kombëtare për Ofrimin e Shërbimeve Postare Nr. 02, datë 04.05.2011, ndryshuar datë 12.07.2011, të Ofruesit të Shërbimeve Postare “Postalink sh.p.k” me të cilën është pajisur nga AKEP.

Zarfi me shkresën e cituar është kthyer nga Posta Shqiptare si adresë e panjohur.

- Sektori i Shërbimit Postar ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë për të komunikuar me anë të adresës elektronike dhe numrave të telefonit që ka deklaruar “Postalink” sh.p.k., por ka qënë e pamundur komunikimi me këtë subjekt. Gjithashtu është verifikuar se, “Postalink” sh.p.k. nuk ushtron më aktivitet në adresën fizike që ka deklaruar në AKEP. Sektori i Shërbimit Postar nuk disponon asnjë pikë kontakti me këtë subjekt.
- Të nisur nga faktet e përmendura më sipër arrihet në përfundimin se:
 - “Postalink” sh.p.k është debitor në AKEP, sepse nuk ka kryer pagesat për licencë për vitin 2013 dhe vitin 2014, me gjithë njoftimet e dërguara këtij subjekti nga AKEP;
 - Periudha e fundit për të cilën “Postalink” sh.p.k. ka raportuar në AKEP për shërbimet postare (Të dhëna statistikore -Formular 14), ka qënë periudha për 6 mujorin e parë të vitit 2013.
 - Kontaktet e deklaruara në AKEP nga “Postalink” sh.p.k. si email, tel, fax nuk janë më të aktivizuara dhe për rreth një vit nuk ka patur komunikim me AKEP;
 - Në adresën fizike të deklaruar të zyrave të kompanisë, është verifikuar nga Sektori i Shërbimit Postar se Postalink sh.p.k. nuk është më present,
- Nga pikëpamja formale procedurale, dokumentacioni i paraqitur për revokimin e licensës Nr. 02, datë 04.05.2011, ndryshuar datë 12.07.2011, të Ofruesit të Shërbimeve Postare “Postalink” sh.p.k, është në përputhje me përcaktimet e parashikuara në Rregulloren Nr. 21, datë 18.03.2011 për “Licencën e Përgjithshme për Ofrimin e Shërbimeve Postare” miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1532, datë 18.03.2011 e ndryshuar, gërma f), pika 2, neni 8 dhe neni 9.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë faktet e përmendura dhe arsyetimin juridik për revokimin e Licencës së Përgjithshme Lokale për Ofrimin e Shërbimeve Postare Nr. 02, datë 04.05.2011, ndryshuar datë 12.07.2011, të Ofruesit të Shërbimeve Postare “Postalink” sh.p.k.,

V E N D O S:

1. Të revokojë Licencën e Përgjithshme Kombëtare për Ofrimin e Shërbimeve Postare Nr. 02, datë 04.05.2011, ndryshuar datë 12.07.2011, të Ofruesit të Shërbimeve Postare “Postalink” sh.p.k.
2. Të njoftohet Postalink sh.p.k. për nxjerrjen e këtij vendimi.
3. Ngarkohen drejtoritë e AKEP për ndjekjen e efekteve që rrjedhin nga ky vendim.
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al.
5. Kundër këtij Vendimi palët e interesuara mund të ankimohen brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit apo publikimit në faqen Eëb të AKEP

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Alketa MUKAVELATI**
3. **Benon PALOKA**
4. **Zamira NURÇE**